VENDIM
Nr. 506, datë 24.6.2020

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA ISH-INSPEKTORATI I KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË, SOT KËSHILLI I LARTË I GJYQËSORIT, TE DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK, TË GODINËS SË ISH-INSPEKTORATIT TË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË (PJESË E ISH-HOTEL "ARBËRIA")

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga ish-Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, sot Këshilli i Lartë i Gjyqësorit, te Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit Publik, të godinës së ish-Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (pjesë e ish-hotel "Arbëria"), sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Departamentit të Administratës Publike i kalon në përgjegjësi administrimi bodrumi, kati përdhes (holli), kati i parë dhe kati i dytë i godinës.
3. Komisionit të Prokurimit Publik i kalon në përgjegjësi administrimi kati i tretë dhe kati katërt i godinës.
4. Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionit të Prokurimit Publik u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e godinës së përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t'ua japin në përdorim të tretëve.
5. Në pikën 1, të vendimit nr. 387, datë 19.8.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për ndryshimin e destinacionit dhe administrimit të hotel 'Arbërisë'", fjalët "... dhe Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ..." hiqen.
6. Ngarkohen Këshilli i Lartë i Gjyqësorit, Departamenti i Administratës Publike, Komisioni i Prokurimit Publik dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama


FRAGMENT HGA PLANIMETRIKE
TIRANËS – HOTEL ARBERIA
TR-N-11
Shkalla 1:500
Rr. "Asim Vokshi"
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Hotel Arbëria
1KT
7KT
6KT
2KT
3KT
Zëri Popullit
Rilievi i Tiranës
Shk. 1:500 Viti 1994
Rilevoi Top. B. Çoku
I.H.GJ.
Përgjegjësi Sek. Gjeodezise
Ing. Qazim Striniqi
Tiranë 2 Nëndor 1994